



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 1074 Prot.

Tiranë, më 5.8 2019

VENDIM Nr. 176, datë 31.07.2019

Në mbështetje të **Ligjit Nr. 27/2018 "Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë"**, Neni 134, Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr. 9, datë 31.07.2019, pasi shqyrtoi Raportin e Vëzhgimit Arkeologjik sipërfaqësor, në kuadër të projektit **"Ndërtimi i HEC Plesat" Bashkia Gjirokastrë**-subjekti "MAGNA ENERGY"sh.p.k., realizuar nga subjekt i licencuar në arkeologji Z. Taulant Rama,

VENDOSI:

1. Të miratojë Raportin e Vëzhgimit Arkeologjik sipërfaqësor, në kuadër të projektit **"Ndërtimi i HEC Plesat" Bashkia Gjirokastrë**-subjekti "MAGNA ENERGY"sh.p.k., realizuar nga subjekt i licencuar në arkeologji Z. Taulant Rama.
2. Subjekti "MAGNA ENERGY"sh.p.k., duhet të lidhë paraprakisht akt-marrëveshje tre palëshe me subjekt të licencuar në arkeologji, i cili duhet të ndjekë në mënyrë periodike ditore kryerjen e punimeve të gërmimit për projektin "Ndërtimi i HEC Plesat" Bashkia Gjirokastrë", si dhe Agjencinë e Shërbimit Arkeologjik, cila do të mbikëqyrë këtë subjekt.
3. Investitori duhet të derdhë detyrimet tatimore për mbikëqyrjen e realizuar nga ASHA, sipas tarifave të miratuara me Urdhërin e Ministrit Nr. 384, datë 21.10.2015 dhe përcaktimeve përkatëse të akt-marrëveshjes tre palëshe.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
5. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

**KRYETAR
ELVA MARGARITI
MINISTËR**



**SEKRETAR I KKA
RUDINA ZOTO**

Adresa: Rruga "Aleksandër Moisiu", Nr. 76, Tiranë

Tel: ++355 04 45 35 855

email: sekretaria.kka@asha.gov.al

Website: asha.gov.al